



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.71/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me sekretaren juridike Drita Qerreti, në kontestin e paditësit KEK – Distrikti në Prizren, të cilin e përfaqëson i autorizuari Bekim Parallangaj nga Prizreni, kundër të paditurit I. K. nga fshati ... komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 139.45 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 31.12.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit KEK – Distrikti në Prizren, përmes të cilës ka kërkuar që “të detyrohet i padituri I. K. nga fshati ... komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit për shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, t’ia paguajë paditësit shumën në lartësi prej 139.45 euro, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia paguaj paditësit shumën prej 15 euro”, **si tërësisht e pabazuar.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë së palës së paditur, konform nenit 423 parag. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi KEK - distrikti në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit I. K., përmes së cilës ka theksuar se paditësi me aktvendimin e Gjykatës Komonale në Prizren P.nr.1025/04, të datës 09.11.2011, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Sipas padisë, i padituri gjatë vitit 2004, në mënyrë të kundërligjshme dhe të pa autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike dhe në këtë mënyrë paditësit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 139.45 euro, andaj edhe nga gjykata është kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia, ashtu që të detyrohet i padituri që t’ia kompensojë dëmin paditëses në shumën e lartcekur.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari e paditësit Bekim Parallangaj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve të cekura në padi dhe kërkesëpadi. Në fjalën e tij të fundit ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar pa dyshim se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se këtu i padituri I. K. i ka borxh në emër të kompensimit të dëmit paditëses shumën në lartësi prej 139.45 euro, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar në bankat komerciale të

Kosovës. Gjithashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës dhe atë vetëm për taksën gjyqësore në shumë prej 15 euro.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje me shkrim në padi, ndërsa siç edhe u cek më lartë, shqyrtimit kryesor është mbajtur në mungesë të tij, konform nenit 423 parag. 4 të LPK-së.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat e propozuara si në vijim: aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.1025/04, të datës 09.11.2011; kopjen e faturës mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, nr.187/2004, të datës 03.06.2004, të lëshuar nga KEK – divizioni i furnizimit në Prizren; si dhe procesverbalin me numër 2142, të datës 03.06.2004.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e **pa bazuar**.

Nga leximi i aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.1025/04, të datës 09.11.2011, gjykata ka provuar faktin se ndaj këtu të paditurit është hedhur poshtë propozimi akuzues për veprën penale të vjedhjes dhe atë për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Nga leximi i faturës mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, nr. 187/2004, të datës 03/06.2004, të lëshuar nga KEK – divizioni i furnizimit në Prizren, gjykata ka konstatuar se dëmi të cilin i padituri ia ka shkaktuar këtu paditësit është në shumën prej 139.45 euro. Mirëpo duke qenë se si e tillë gjykatës i është dorëzuar në formë kopje dhe pa vulë të organit i cili e ka lëshuar, të njëjtës gjykata nuk ia fali besimin.

Nga leximi i procesverbalin me numër 2142 të datës 03.06.2004, të lëshuar nga KEK Prizren, gjykata ka konstatuar se konsumatori (këtu i padituri) është hasur duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar. Edhe kjo provë duke qenë se si e tillë gjykatës i është dorëzuar në formë kopje dhe pa vulë të organit kompetent, të njëjtës gjykata nuk ia fali besimin.

Baza ligjore

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se “*kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “*në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “*palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se “*Gjykata është e*

autorizuar që t'i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t'i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...”, gjë që sipas bindjes së gjykatës, në këtë çështje nuk kemi të bëjmë me kërkesa të tilla.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar se këtu i padituri, ka detyrim për kompensimin e dëmit ndaj paditësit KEK – Distrikti në Prizren. Në rastin konkret, paditësi nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë bindëse në lidhje me borxhin (dëmin e shkaktuar) e pretenduar për këtë periudhë. Në të vërtetë, paditësi ia ka ofruar gjykatës si provë aktvendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren Prizren P.nr.1025/2004, të datës 09.11.2011, por me të njëjtin është hedhur poshtë propozimi akuzues për veprën penale të vjedhjes, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale dhe nuk ka mundur të vërtetohet përgjegjësia eventuale penale e të paditurit. Po ashtu paditësi si provë gjykatës i'a ka parashtruar edhe kopjen e faturës mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike, me numër 187/2004, të datës 03/06.2004, por të njëjtës gjykata nuk i'a fali besimin pasi që e njëjta është në formë të kopjes, e pa vërtetuara nga organi i paditësi për më tepër kjo provë nuk mban as vulën e organit apo personit përgjegjës të organit i cili do të duhej ta lëshonte atë, e përmes kësaj duhet të vërtetohet saktësia e saj, ku për shkak të kësaj edhe nuk ka qenë e mundur që të vërtetohet dëmi i shkaktuar për periudhë konkrete. Ngjajshëm është edhe me provën – procesverbalin me numër 2142 të datës 03.06.2004, të lëshuar nga KEK Prizren, të cilit për arsye të njëjta të lartcekura gjykata nuk ka mundur t'ia fali besimin, andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave dhe duke qenë se paditësi nuk i ka ofruar gjykatës prova të mjaftueshme dhe bindëse, përmes të cilave do të argumentohet e drejta e tij në kompensimin e dëmit të pretenduar për periudhën e caktuar, edhe pse për këtë në seancën e shqyrtimit kryesor është ftuar nga ana e gjykatës, pasi që *onimus probandi* lidhur me pretendimet e tij, i ka takuar atij si paditës që është, kjo gjykatë nuk mundi ta aprovojë kërkesëpadinë e këtij të fundit, respektivisht të njëjtën u deshtë që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN C.nr.71/12, datë 31.12.2014

Sekretarja juridike,
Drita Qerreti

**Gjyqtari,
Valon Totaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.